



Datë: 30.01.2026
Numër Protokolli: 685/2026

A.nr.1972/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1972/2025, të datës 02.12.2025, të parashtruar nga ankuesi G.E, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 30.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1972/2025, të datës 02.12.2026, të parashtruar nga ankuesi G.E.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil G.E (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 02.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër mos zbatimit të Vendimit A.nr.1364/2025, të datës 04.09.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar së lidhur me këtë çështje juridike-administrative janë plotësuar kërkesat ligjore për përfundim të procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i provave të çështjes rrjedhë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.1364/2025, të datës 05.09.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 15.07.2025, duke e detyruar Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore të MPB-së, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të vendimit ta rishqyrtoj kërkesën e datës 16.05.2025 m të cilën ankuesi ka kërkuar kompensim të funksionit shtesë si anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Tutje, organi i punësimit më datë 30.01.2026 ka përcjell shkresën njoftuese (përmes emailit) të Këshilli më njoftimin: *“Lidhur me Vendimin e KPMSHCK, për zbatim në rastin e G.E, MPB ka zbatuar këto vendime, duke i ekzekutuar një pagesë si dhe ka proceduar edhe pagesat tjera...”*

Duke qenë së ankesa e ankuesit ka të bëj më mos zbatimit të vendimit A.nr.1364/2025, të datës 04.09.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, meqenëse organi i punësimit ka filluar që të ekzekutoj kërkesën materiale të ankuesit si objekt i kësaj ankese, atëherë, mbi këto rrethana e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot..*, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar më ankesën A.nr.1972/2025, të datës 02.12.2025, sepse, tani objekti i ankesës është bërë i paarsyeshëm për vendosje.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1972/2025

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, G.E;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.